



## Përgjigjet e pyetjeve

### Pjesa e parë

- 1.1** 1. Rreth 2.2 miliardë vite më parë.  
 2. Aminoacide, acide yndyrore, sheqerna, acide nukleike/nukleotide.  
 3. Për shembull, **ring boksi, rinia**.  
 4. Për të zëvendësuar individët që vdesin / të sjellë në jetë më shumë individë për kolonizimin e mjediseve të reja / të kombinojë materialin gjenetik të individëve të ndryshëm (të mundësojë variacionin).
- 1.2** **1 a.** Kanë shumë të zhvilluar dhëmbët prerës.  
 b. Nuselala dhe vizoni (i takojnë të njëjtës gjini).  
 c. Dhelpra (të tjerat janë në të njëjtën gjini).  
 d. Ata gëlltitin molekula organike të gatshme.
- 2.** Njeri me arsye.  
**3.** Viruset nuk shfaqin asnjë veçori të qenieve të gjalla, veçse kur janë brenda qelizave të një organizmi tjetër.  
**4 a.** Lloji 1: ka vetëm një llapë në frondet e veta;  
 lloji 2 ka buzë të dhëmbëzuara në fronde;  
 lloji 3 ka llapë të dyfishtë në fronde;  
 lloji 4 ka një frond të vetëm të gjerë me buzë të valëzuara; lloji 5 ka një pjesë në formë rrënje në bazën e vet.  
**b.** P.1: Ka një pjesë në formë rrënje në bazën e vet.  
 Lloji 5  
 Nuk ka pjesë në formë rrënje në bazën e vet, shkoni te P.2  
 P.2: Ka llapë (trasta ajri) në fronde, shkoni te P.3. Nuk ka llapë të vetme, shkoni te P.4.  
 P.3: Ka llapë e vetme, lloji 1.  
 Llapë e dyfishtë, lloji 3.  
 P4: Fronde me buzë të dhëmbëzuara, lloji 2.  
 Fronde me buzë të valëzuara, lloji 4.  
 Mund të ketë edhe përgjigje të tjera të pranueshme.

- 1.3.1.** Kanë rrënjë për përthithjen e ujit dhe joneve minerale, si dhe tufa përçuese për transportin e joneve minerale në organizmin bimor.
- 2.** Gametët e tyre mund të transferohen në mënyrë të pavarur nga uji.
- 1.4.1.** Ata gëlltitin molekula organike të gatshme; shtyllë kurrizore; artropodët (këmbënyjëtuarit).
- 2 a.** Kanë trup të segmentuar, këmbë të segmentuara/kanë skelet të jashtëm të fortë.  
**b.** Dy palë krahë/tri palë këmbë/tri pjesë kryesore të trupit/cikël jetësor me metamorfozë.  
 c. Insektet (6, 3, 4 të përbëra), merimangat (8, 2 jo, të thjeshta).
- 3.** Cikli jetësor ka katër stade të dallueshme: vezët, larvë, pupë/ krisalidë/të rritur. Stadet e ndryshme nuk konkurrojnë për të njëjtat burime ushqimore, larva është e specializuar për t'u ushqyer e rritur, forma e rritur është specializuar për lëvizje dhe riprodhim.

### Veçoritë dhe klasifikimi fq.14

1.

	1a	1b	2a	2b	3a	3b	4a	4b	5a	5b	name
<b>A</b>											
<b>B</b>	√		√		√						Anopheles
<b>C</b>		√						√			Ornithodoros
<b>D</b>		√					√		√		Pulex
<b>E</b>	√			√							Musca
<b>F</b>	√		√			√					Periplaneta

- 2 a.** Elephas – gjinia; maximus – lloji.  
 b i. Jaguar/ leopard/luan/tigër OSE gepardi/rrëqebulli europian/rrëqebulli spanjoll.  
 ii. Gepardi/Acynonyx.
- 3 a.** I përbërë nga shumë qeliza – kafshë – vertebror – lëkurë e mbuluar – gjitar.  
 c. Ecën vertikalisht/ komunikon me anë të gjuhës.

## Pyetje për qelizën dhe ndërtimin e organizmave të gjalla (faqe 120-121)

1

Qeliza	Inde	Organe
Fagocite, neurone, spermatozoide	Epiderma, ksilema, gjaku	Mëlçia, zemra, gjethe, zorra, vezorja, truri, kërcelli

2. Organela – qeliza – organi – sistemi – organizmi.

3. Kilometër – metër – milimetër – mikrometër;

$$\frac{1000}{50} = 20$$

4. a.  $(100 - \{23 + 13 + 0.5 + 24 + 8 + 11 + 0.1\}) = 20.4$

b. Kujdes që për grafikun të merrni parasysh edhe shifrën 20.4 për qelizat e tjera.

c.  $\frac{13}{100} \times 100\,000\,000\,000\,000 = 13\,000\,000\,000\,000$

5.

Struktura	Qeliza të mëlçisë	Qeliza palisade të mezofilit
Membrana qelizore	√	√
Kloroplaste	×	√
Citoplazmë	√	√
Mure qelizore prej celuloze	×	√
Bërthama	√	√
Kokrriza niseshteje	×	√
Kokrriza glikogjeni	√	×
Vakuola të mëdha dhe të përherëshme	×	√

6. Zgjidhni një shembull nga pyetja 5.

Një përgjigje e mirë do të duhej të përfshinte shembuj nga bimët dhe kafshët/shembuj për ndërtimin dhe biokiminë.

7.

Frymëmarrja	Çlirimi i energjisë nga molekulat organike
Ndjeshmëria	Aftësia për të zbuluar ndryshimet e mjedisit
Rritja	Ndryshimi në madhësi
Riprodhimi	Lindja e pasardhësve
Ushqyerja	Furnizimi me ushqim
Ekskretimi	Largimi i mbetjeve të metabolizmit nga organizmi
Zhvillimi	Ndryshimi në formë

8.

Membrana qelizore	g. Kontrollon hyrjen dhe daljen e lëndëve.
Muri qelizor	c. Përmban celulozë dhe rrethon qelizat bimore.
Kloroplastet	a. Struktura që përmbajnë klorofil.
Kromozomet	e. Fijeza të ngjyrosura që takohen brenda bërthamës.
Citoplazma	d. Lëndë në trajtë veshulllore që mbush pjesën më të madhe të qelizës.
Mitokondria	f. Vendi i frymëmarrjes qelizore.
Bërthama	h. Mbart informacionin gjenetik dhe kontrollon aktivitetin qelizor.
Vakuola	b. Zgavra që takohen vetëm në qelizat bimore.

9. Rruazat e kuqe të gjakut: b; rruazat e bardha të gjakut: g; qelizat e veshjes së brendshme të mushkërive: f; qelizat nervore lëvizore: e; qelizat palisade: i; qelizat e qimeve thithëse: a; gypat e floemës: d; spermatozoidet: c; vezët: h.

10.

Stomaku	Organ
Mitokondria	Organelë
Macja	Organizëm
Bulbi i qepës	Organ
Bima e karotës	Organizëm
Kloroplasti	Organele
Neuroni	Qelizë
Mushkëria	Organ
Truri	Organ
Zemra dhe qarkullimi	Sistem
Ksilema	Ind
Veshja e mushkërive	Ind

11. a. – E; b – A; c – D; d – C; e – B

12. a. Qeliza – ind – floema/ksilema/ gjaku – organ – sistem – sistemi i ekskretimit.

b. E specializuar e kuqe gjaku – pune – nervor – endokrin.

c. Qeliza palisade – kloroplaste – gjethe – epiderma – ksilema.

2.2.1. Strukturë që lejon disa molekula/ pjesëza të kalojnë përmes saj dhe të pengojnë kalimin e disa molekulave të tjera. Për shembull, membrana që vesh



zorrën lejon glukozën e aminoacidet dhe pengon niseshtenë dhe molekulat e proteinave të mëdha.

2. Ndryshimin mes përqendrimit më të lartë dhe atij më të ulët të një lënde të tretur.
3. Lëvizja e gazeve (p.sh. oksigjeni dhe dioksidi i karbonit), mbetjeve (p.sh. ureja), hormoneve (p.sh. insulina).
4. Sipërfaqe e madhe/membranë e hollë (rrugë e shkurtër për difuzionin)/aftësia për të ruajtur gradientin e difuzionit.
5. Citoplazma; pjesërisht e përshkueshme; fryhet; pakësuar; qelizor; glukozë/ aminoacide; difuzion; gradient përqendrimi; transport aktiv; energji; kundër; dioksid karboni; difuzion; fotosintezë.

6.

	DIFUZION	TRANSPORT AKTIV
Përdor energjinë e ATP-së	Jo	Po
Drejtimi i lëvizjes	Sipas gradientit të përqendrimit	Kundër gradientit të përqendrimit
Përfshijnë molekula transporti	Jo	Po
Shembuj	Lëvizja e oksigjenit nga alveolat në gjak	Kapja e joneve minerale nga qime thithëse të rrënjëve
Përdorin fagocitozën për kapjen/ lëvizin pjesëza të mëdha përmes membranës		

### Difuzioni dhe osmoza (faqe 27)

- 1 i. E turguar do të thotë “e fryrë tërësisht nga uji”.
  - ii. Qelizat bimore të turguara shtyhen drejt qelizave fqinje dhe të gjitha së bashku sigurojnë mbështetjen e bimës.
  - iii. Gota e ujit (bekeri) A.
  - iv. Copa në gotën B.
  - v. Copa e patates dalëngadalë forcohet dhe mund të mbajë një peshë prej 10 g.

Kjo ndodh sepse uji hyn brenda copës së patates përmes osmozës (sipas gradientit të përqendrimit). Qelizat turgohen dhe mbështesin copën e patates.

- 2 a. Në boshtin x të grafikut vendoset përqendrimi i tretësirës së sheqerit, ndërsa në boshtin y vendoset përqindja e ndryshimit të gjatësisë.
  - b. 0.24 mol për  $\text{dm}^3$ . Në këtë përqendrim nuk ka osmozë të pastër e për rrjedhojë përqindja e ndryshimit të gjatësisë është zero.
  - c. Sepse duke përdorur ndryshimin e përqindjes, nuk lëmë pa marrë parasysh ndryshimin në gjatësinë fillestare.
- 2.3. 1. Sheqernat (burimi i energjisë)/yndyrat (energji e ruajtur/proteinat (enzimat)/ acidet nukleike (informacioni gjenetik).
2. Molekulat e tretshme mund të transportohen në gjak dhe përshkojnë membranat/ molekulat e patretshme nuk mund të transportohen në mënyrë të tillë. Ato mund të ruhen në mënyrë të shkëlqyer.
3. Acidet nukleike kontrollojnë funksionet qelizore dhe mbartin informacionin e koduar gjenetik. Proteinat rregullojnë aktivitetin e qelizave, p.sh. në rolin e tyre si enzima. Sheqernat përdoren zakonisht si burim energjie, për mbajtjen gjallë të qelizave.
- 2.4 1 a. Dhjami, gjalpi etj. janë të ngurtë në temperaturën e dhomës/vaji është në trajtë të lëngët në temperaturën e dhomës.
  - b. Në përpjesëtim me këto elemente, oksigjeni zë përqindjen më të madhe.
  - c. Tregoni skeletin që përmban glicerolin dhe tre acide yndyrore. Yndyra të ndryshme përmbajnë acide yndyrore të ndryshme.

- 2 a A. Ujërat larëse të lavanderisë (përmbajnë niseshte); B. qumështi (përmban laktozë dhe proteina); C. çaji i ëmbël (jep ndjesinë pozitive të sukrozës); D. pure patatesh (përmban niseshte dhe sasi të vogël proteinash); E. urina e një individi diabetik (përqendrim i lartë glukozë).
3. 1. Testoni reagentët nëse janë në rregull

- duke bërë prova me lëndë të “njohura”.
2. Për të parë nëse reagentët janë të ndotur bëni një provë me ujin që keni përdorur si tretës. Ky i fundit duhet të japë rezultat negativ.
- 2.5. 1.** proteinat; reaksionet/proceset; katalistët; specifik; denaturuar.
2. Vizatoni një figurë të përmbysur (d.m.th. një molekulë që në qendrën aktive mban dy produkte): çdo enzimë tretëse mund të shërbente si një shembull i përshtatshëm.
- 2.6 1 b. 0.25/0.50/2.0/0.5/0.25/0.08
- c. Në boshtin x temperatura dhe në atë y niveli, niveli maksimal në 35 °C. Mbi 35°C niveli rritet, meqenëse molekulat fitojnë energji kinetike dhe mund të përplasen më shpesh dhe me energji më të lartë, por poshtë kësaj temperature molekulat e enzimës çnatyrohen. Qendra aktive nuk e njeh më substratin e për rrjedhojë niveli ulet. Temperatura 35°C është temperatura optimale për këtë enzimë.
- Enzimat dhe molekulat biologjike (faqe 36-37)**
- 1 a. Enzima është katalizator biologjik: ajo përshpejton reaksionin biologjik pa u ndryshuar vetë.
  - b. Vendosni etiketimet në boshte/boshte vijëzore/vizatim i kujdesshëm/titulli.
  - c. Në stomak (pH 2).
  - d. Niveli mund të jetë zero/i ulët deri sa zierja ka çnaturuar enzimën.
  - 2 a. Ekskretim
    - b i. pH
    - ii. Përqendrimi i enzimës, përqendrimi i substratit, temperatura.
  - c.  $\frac{10}{17.4} = 0.57$
  - d. Vendosni etiketat e boshteve (në boshtin x pH/boshte vijëzore/saktësi në vizatim/titulli).
  - e i. ka rritje të nivelit (nga 0.50 to 1.00) midis pH nga 4 në 6, pastaj zvogëlim 0.57 për pH nga 6 deri në 8.
  - ii. Niveli i reaksionit ulet meqenëse enzima çnatyrohet (humbet forma e qendrës aktive) e për rrjedhojë do të ketë më pak përplasje mes enzimës dhe molekulës së substratit.
- 3 a i. Vendosni etiketat e boshteve (në boshtin x pH/boshte vijëzore/saktësi në vizatim/titulli)← .
  - ii. Niveli i reaksionit ulet meqenëse enzima është çnaturuar (humbet forma e qendrës aktive) e për rrjedhojë do të ketë më pak përplasje mes enzimës dhe molekulës së substratit.
  - b i. Temperatura të ndryshme/pakujdesi në matjen e kohës
  - ii. Besueshmëria: përsëritje eksperimenti dhe marrja parasysh e vlerës mesatare, temperaturë fikse.
- 4 a. Saktësi në vizatim. Grafiku në formë kulaçi vizualisht është më informues dhe po ashtu është më lehtë të vihen re përpjesëtimet e elementeve të ndryshme.
  - b i. uji; ii. proteina; iii. ujë; iv. yndyra; v. vitamina; vi. kocka dhe dhëmbë.
- 5 a i. Saktësisht korrekte, ii dhe iii kanë gjasa të jenë të saktë.
  - b. D është kontrolli, që tregon se niseshteja nuk mund të tretet pa praninë e enzimës/pështymës.
  - c. Bëni një kontroll të dytë në temperaturën 30°C; vendosni një provëz me pështymë të vluar paraprakisht në temperaturën 30°C.
  - d. Pranohet maltozë ose glukozë (e reduktuar). Testi i Benediktit është i përshtatshëm: ngrohja e reagentit duke shtuar vëllim të njëjtë të reagentit të Benediktit. Kur ngjyra ndryshon nga blu e zbehtë në portokalli të kuqe prova për sheqerin e reduktuar është pozitive.
2. 7 1. Etanoli tret klorofilin dhe e zhvendos atë nga gjethja.
  - 2 a. Drita është e domosdoshme për fotosintezën.
  - b. Për fotosintezën nevojitet dioksid karboni.
  - c. Tregon se niseshteja është i vetmi produkt nëse klorofili është i pranishëm.
  - d. Dioksidi i karbonit, drita dhe klorofili.
- 3 a. Mbajeni bimën në errësirë për 48 orë: ajo humbet niseshtenë dhe mund të provohet për praninë e kësaj lënde.
  - b. Mund të zëvendësoni letrën e zezë me një letër transparente.
4. Mund të nxehet një gjethë për të çnaturuar enzimën: një gjethë e tillë nuk është më e aftë të prodhojë niseshte nga fotosinteza.



**2.8 1.** Ato kanë të njëjtën madhësi/të njëjtin vëllim.

**2 a.** Tregoni që kurba arrin tavanin në nivelin e rreth 7 njësie arbitrare të intensitetit të dritës (kujtohuni të etiketoni boshtet).

**b.** 3.5. Njësi arbitrare.

**c.** Deri në 7 njësi: kur kalohet mbi këtë vlerë nuk ka rritje.

**d.** Gjatësia e valës dritore. Përdorni filtra me ngjyra.

**e.** Përqendrimi i dioksidit të karbonit/temperatura/pH/lloji i gjethes.

**f.** Për përmirësimin e vlefshmërisë së të dhënave.

**g.** Për të dhënë rezultatin si vëllim i prodhuar për g ind bimor, d.m.th. shmanget një ndryshore tjetër e mundshme.

**h.** E pavarur = temperatura, e varur = vëllimi i oksigjenit të prodhuar në minutë/e fiksuar = dioksidi i karbonit/intensiteti të dritës/gjatësia e valës së dritës/lloji i gjethes.

**3 a.** CO<sub>2</sub> “radioaktiv” trajtohet nga bima në të njëjtën mënyrë si CO<sub>2</sub> normal.

**b.** Me fjalë të tjera, rezultati i përfutur në këtë eksperiment nuk mund të merret në një bimë tjetër në kushtet normale.

**c.** Frymëmarrja

**2.10.1.** Intensiteti i dritës/temperatura, përqendrimi i dioksidit të karbonit.

**2.** Mund të prodhojë shiun acid, i cili dëmton mezofilin e gjethes. Megjithatë, temperatura e lartë dhe përqendrimi i lartë i CO<sub>2</sub> mund të rritë nivelin e fotosintezës.

**3.** Magnezi: ky jon është pjesë e molekulës së klorofilit.

**4.** Faktori që është më larg optimumit të tij, d.m.th. që pakëson nivelin e fotosintezës.

**a.** Intensiteti i dritës

**b.** Temperatura

**c.** Përqendrimi i dioksidit të karbonit

**2.11.1.** Indikator i hidrogjenkarbonatit (bikarbonatit): ndryshon nga i kuq në rozë. Ngjyra rozë tregon që tretësira është më pak acide. Kjo gjë ndodh në prani të një gjetheje që kryen fotosintezë sepse ajo largon CO<sub>2</sub> nga tretësira.

**2.** Është pika në të cilën fotosinteza dhe frymëmarrja balanohen, pra kur sasia e oksigjenit të konsumuar nga frymëmarrja barazohet me sasinë e oksigjenit të çliruar nga fotosinteza. Kjo është e rëndësishme, sepse tregon kur bima prodhon më shumë sheqer sesa konsumon.

**3.** Po, është e vërtetë, por nuk përfundon deri

këtu. Bimët mund t'i përdorin sheqernat e prodhuara gjatë fotosintezës për të prodhuar të gjitha molekulat organike (siç janë aminoacidet dhe yndyrat).

**4.** Bimët kapin CO<sub>2</sub> për të prodhuar glukozë. Ato përdornin një pjesë të glukozës për frymëmarrje, që do të thotë se në këtë proces çlirohet CO<sub>2</sub>, që kalon në atmosferë. Kjo sasi CO<sub>2</sub> kapet përsëri nga bima për të vazhduar fotosintezën.

### Fotosinteza dhe të ushqyerit e bimës (faqe 50-51)

**1 a i.** Pjesa më e madhe e ujit humbet nga sipërfaqja e poshtme e gjethes.

**ii.** Sipërfaqja e sipërme: kutikula dyllore dhe mungesa e gojëzave kufizon humbjen e ujit; sipërfaqja e poshtme nuk ka kutikulë, por ka gojëza të cilat lejojnë lirisht humbjen e ujit.

**b.** Gjethja mund të jetë e lagur/letra mund të jetë e lagur.

**c.** Përdorni më shumë gjethe/përsëritni eksperimentin/vendosni letrën në pjesë të ndryshme gjethes. Në të gjitha rastet bëni mesataren e rezultateve.

**d.** Përdorni për kontroll një pjesë letre të klorurit të kobaltit, mos e bashkoni me sipërfaqen e gjethes dhe nuk duhet të kalojë shumë kohë për të marrë ngjyrën rozë.

**2 a.** Osmoza – mbështetje – tretje/mjedis transporti – fotosintezë.

**b.** Rrënjë – qimet thithëse – sipërfaqe – jone/minerale – magnez – nitrat – transport aktiv-energji.

**c.** Ksilemë – floemë – përçuese

**3 a i.** Dioksid karboni dhe ujë

**ii.** Oksigjen

**b i.** Tretësirë jodi

**ii.** A – ngjyrë kashte të errët; B – ngjyrë kashte të errët; C – blu e errët; D – ngjyrë kashte të errët

**iii.** B: klorofili nuk është i pranishëm, prandaj nuk ka fotosintezë. Energjia nuk mund të përthithet; D: megjithëse klorofili është i pranishëm, mbulesa e zezë pengon dritën të arrijë në gjethe, ndaj nuk mund të kryhet fotosinteza.

**4 a i**

Provëza	Ngjyra e indikatorit në fillim	Ngjyra e indikatorit pas 6 orësh
A	rozë	e verdhë
B	rozë	e verdhë
C	rozë	e verdhë
D	rozë	e kuqe-vjollcë

**ii.** Provëza A:

1. frymëmarrje;

2. prodhohet dioksid karboni që çlirohet në ujë;
3. bëhet acid / më shumë acid / e pH.

Provëza D:

4. ndodh fotosinteza;
5. dioksidi i karbonit largohet nga uji;
6. bëhet alkaline/më pak acid/ rritet pH.

**b. Provëza E:**

1. qëndron e kuqe-vjollcë/nuk ndryshon;
2. frymëmarrja dhe fotosinteza në balancë;
3. sasia e dioksidit të karbonit në ujë/ pH nuk ndryshon

OSE:

1. ngjyra bëhet vjollcë;
2. fotosinteza më e madhe sesa frymëmarrja;
3. sasia e dioksidit të karbonit në ujë bie/rritet;

OSE:

1. ngjyra bëhet e verdhë;
2. frymëmarrja më e madhe se fotosinteza;
3. rritet sasia e dioksidit të karbonit në ujë/ ulje e pH;

- 2.13.1.** Si burim energjie/si lëndë e parë/si burim vitaminash dhe mineralesh që duhen për shfrytëzimin e lëndëve të tjera.
- 2c.** Ushqyerja autotrofe përfshin ndërtimin e molekulave organike nga materiale joorganike të thjeshta, p.sh. përgatitja e niseshtesë nga dioksidi i karbonit dhe uji. Në ushqyerjen heterotrofe organizmi e siguron lëndën organike të gatshme (në formën e ushqimit).
3. Dieta e balancuar i përmban të gjitha lëndët ushqyese në përpjesëtimin e duhur.
  4. Sheqernat dhe yndyrat
  5. Si enzima (p.sh. amilaza), si hormone (p.sh. insulina), si material ndërtimi (p.sh. keratina) dhe transportuese (p.sh. hemoglobina).

**2.14. 1. a.** 8400 kJ

**b.** 1000 (10 x 100)

**c.** 18900 – 10500 = 8400 kJ (= 80%)

**d. i.** Ushqimi 1 ka përmbajtje më të lartë energjie për racion.

**ii.**  $\frac{18900}{3000} = 4.97$  "racione", d.m.th. 497 g

1. (faqe 57)

**a.** A

**b.** D

**c.** C

**d.** D

**e.** A

**2. a.** Ka më shumë proteinë (400%), pak yndyra (63%), pak sheqer (44%).

**b.** 1 litër përmban 10 x 100 cm<sup>3</sup>, pra përmban 20 g proteinë.

**c.** Çdo lloj agrumi, p.sh. portokalli.

### 2.15. 1.

56	20	1120	2489
52	20	1040	2000
54	20	1080	2298
Kolonë e tepërt			10,454, 8,400, 9,652

**c.** 9502 kJ për g. Ajo është e vlefshme sepse pakëson efektin e një rezultati të vetëm.

**d.** Jepni disa mendime për pakësimin e humbjes së nxehtësisë në ajër dhe sigurohuni që sa më shumë nga nxehtësia e çliruar gjatë djegies të rritë temperaturën e ujit. Thelbi duhet djegur plotësisht.

**e.** Nxënësit e përsëritin eksperimentin duke përdorur të njëjtën pajisje/të njëjtin termometër. Nxënësit i shndërrojnë rezultatet në "për gram" për të marrë në konsideratë peshat e ndryshme të thelpinjve.

**2.17.1.** Përthypja, gëlltitja, tretja kimike, përthithja, jashtëqitja.

**2. a.** Tretja kimike: shpërbërja enzimmatike e ushqimeve; tretja mekanike: copëtimi i ushqimit në pjesëza më të vogla.

**b.** Përthithja: kalimi i pjesëzave të tretura në muret e zorrës së hollë; përvetimi: molekulat e transportuara me anë të gjakut bëhen pjesë e funksioneve qelizore.

**c.** Jashtëqitja: largimi nga gypi ushqimor i materialeve të patretura në formën e feçeve; ekskretimi: largimi me anë të sistemit të ekskretimit të ujit dhe mbetjeve metabolike në formën e urinës.

**3.** Qiellza e butë pengon kalimin e ushqimit drejt hapësirës së hundës; epiglota pengon kalimin e ushqimit në trake.

**4.** Gjëndrat e pështymës.

**2.18.1.** Ai rritet dhe është i ndjeshëm! Dhëmbi gjithashtu ushqehet.

**2 e.** Detarët kishin dietë të varfër. Ishte e vështirë të mbanin fruta të pasura me vitaminë C për një kohë të gjatë. Pa këtë vitaminë nuk formohen fibrat që i mbajnë dhëmbët në folenë e tyre e për pasojë dhëmbët bien. Kjo është simptoma e skorbutit, që mund të parandalohet duke marrë lëngje që përmbajnë vitaminë C.

**3.a.b.** Kariesi fillon kur bakteret futen në Smalt dhe infektajnë dentinën e dhëmbit.

**c.** Duke shmangur ëmbëlsirat (përmbajnë lëndë ushqyese për bakteret, të cilat i shndërrojnë ato në acid) dhe pijet acide të



gazuara. Për të kufizuar kariesin, dhëmbët duhen larë rregullisht (largohen bakteret) dhe uji të pijshëm i shtohet fluor (forcon smaltin).

### 2.19 1 a B.

**b i.** Temperatura

**ii.** Mishi i vendosur në ujë.

**iii.** Për të qenë i sigurt që pastërmaja ishte sterile, që nuk përmbante mikroba të cilat mund ta tretnin mishin tërësisht në stomak, ku mund të kishte pH dhe temperaturë optimale për to.

### 2 a. Tëmthi

b. Emulgon yndyrat: rrit sipërfaqen e tyre duke i krijuar kushte lipazës për hidrolizën e yndyrave deri në acide yndyrore dhe glicerol.

3. Goja: amilaza fillon hidrolizën e niseshtesë deri në maltozë. Stomaku: aktiviteti i amilazës pushon. Proteaza fillon hidrolizën e peptideve në kushtet e një mjedisi acid. Duodenum/ileum: amilaza hidrolizon niseshtenë deri në maltozë, ndërsa maltaza hidrolizon maltozën në glukozë; proteazat plotësojnë hidrolizën e peptideve deri në aminoacide.

4. Tëmthi (shihni pyetjen 2); acidi klorhidrik i stomakut krijon pH optimal për proteazat.

2.20 1. Në mëlçi arrijnë dy enë gjaku: arteria hepatike (gjak i oksigjenuar) dhe vena portë- hepatike (ushqimet e tretura). Nga mëlçia del vena hepatike (ushqime të përvetuara që nisen drejt qelizave përmes venës zgavrore ose kava).

2. Glikogjeni dhe hekuri. Aminoacidet shndërrohen në proteina. Teprica e aminoacideve shndërrohen në ure.

3. Sipërfaqe e madhe/e veshur me membranë të hollë/ shumë enë gjaku (kapilarë) për të ruajtur gradientin e përqendrimit përmes largimit të lëndëve ushqyese të përthithura.

4. Qelizat e mukosit prodhojnë dhe sekretojnë mukus, i cili shërben për mbrojtjen e veshjes së brendshme të gypit ushqimor nga lëngjet tretëse. Ato takohen gjithashtu në veshjen e rrugëve të ajrit, kryesisht të trakesë dhe bronkeve.

5. Uji i tepërt humbet me feçet: barku (diarreja).

### Ushqyerja e kafshëve dhe shëndeti (faqe 72-73)

1 a i. Zbulon niseshtenë me tretësirë jodi, duke dhënë ngjyrë blu të errët.

**ii.** Produkti është sheqeri i reduktuar: prova zbulon sheqerin e reduktuar duke

e zier bashkë me tretësirën e Benediktit, e cila jep ngjyrë portokalli në të kuqe.

**b I.** Bëni kujdes për ndërtimin e grafikut. Niveli maksimal arrihet në pH 4/etiketat e boshteve pajisen me njësitë përkatëse/ bëhet çelësi për të dalluar lakoret.

**ii.** pH optimal 4/ prania e kripërave rrit shpejtësinë e reaksionit mbi të gjithë gamën e pH.

**c.** Rezultatet do të jenë më të besueshme nëse eksperimentet përsëriten dhe përdoren mesataret e rezultateve. Rezultatet mund të jenë të vlefshme nëse ndryshon vetëm një **ndryshore** e çdo eksperimenti, si p.sh. ruajtja e temperaturës/përqendrimi i enzimës/përqendrimi i substratit.

2 a. Sarës: ajo ka vetëm katër mbushje dhëmbësh, ndërsa Ogerta ka tetë të tilla.

**b.** Ndoshta për arsye të variacionit gjenetik/ Ogerta mund të ketë konsumuar shumë ëmbëlsira/ ushqime të ngjytshme/ mund të ketë pirë pije freskuese acide/pije freskuese të gazuara.

**c.** Kjo shmang gjininë dhe moshën nga listat e ndryshoreve të pavarura.

**d.** Dhëmballët bluajnë ushqimet, kështu që ushqimet e ngjytshme qëndrojnë më gjatë aty. Këto ushqime mund të futen në të ndarat e dhëmballëve.

**e.** Në këtë moshë nuk ka shumë zgavra e për më tepër në këtë moshë nuk ka kaq shumë dhëmbë e dhëmballë të qumështit.

### 3

pH	5.0	5.5	6.0	6.5	7.0	7.5	8.0	9.0
Koha/sek	20.00	15.00	8.00	4.00	1.25	1.25	3.00	8.00
Shpejtësia e reaksionit	0.05	0.07	0.13	0.25	0.8	0.8	0.33	0.13

**b.** pH në boshtin x/boshtet drejtvizore/ shënoni njësitë në boshte/punoni me kujdes për vizatimin.

**c.** 7.0 – 7.5

**d.** goja/ileum: prania e bikarbonatit të natriumit

**e.** prova e jodit për niseshtenë/prova e Benediktit për sheqerin e reduktuar.

**f.** temperatura/përqendrimi i enzimës/përqendrimi i tretësirës së niseshtesë

### 4

Lënda ushqimore	Enzima tretëse	Produkti përfundimtar i tretjes
Niseshteja	Amilaza	Sheqer i thjeshtë
Proteina	Proteaza	Aminoacide
Yndyra	Lipaza	

**b.** Teprica e glukozës ruhet në formën e glikogjenit të patretshëm; teprica e

aminoacideve deaminohet në ure dhe dioksid karboni.

5. Shumë përgjigje të mundshme. Rezultatet duken të pavlefshme deri sa nuk pati të dhëna kontrolli. Kontrollat e besueshme (përdoren kafshë/më shumë individë).
6. Vetë.

Bounty, 60 g	818
Malteser	2016
Mars	1816
Milky Way	1960
Minstrels, 49 g	1775
Snickers	2016
Treets, 42 g	2476
Twix	2016

**b.** Grafik me shtylla: të jenë të ndara nga njëra-tjetra.

**c i.** Minstrels

**ii.** Treets

**d.** 1179

**e i.** 196.5 minuta;

**ii.** shfrytëzohet për të ruajtur temperaturën/ për të mbajtur sistemin nervor në punë/ për të tretur ushqimin.

**f.** 39 minuta.

**g.** më shumë: ai mund të shfrytëzojë një pjesë të energjisë në rezervë, p.sh. glikogjenin e mëlçisë.

**2.21 1.** Potencial i ulët i ujit: pjesëzat e tretura tentojnë të kapen fort te molekulat e ujit e në këtë mënyrë uji nuk mund të ketë potencialin e duhur për t'u larguar.

**2.** Osmoza është lëvizja e ujit përmes një membrane pjesërisht të përshkueshme sipas gradientit të përqendrimit.

**3.** Ndërsa citoplazma fryhet ajo shtyhet drejt murit qelizor të celulozës. Muri qelizor tendoset lehtësisht dhe shtyhet drejt qelizës fqinje. Në këtë mënyrë qelizat sigurojnë mbështetjen për të mbajtur trupin e bimës (qelizat janë të turguara).

**4 a.** Kapja përfshin enzimat ose transportuesit: temperatura e lartë u jep molekulave lëvizëse më shumë energji kinetike.

**b.** Duhet energji (nga frymëmarrja) për kapjen.

**c.** Ky është një shembull i transportit aktiv. Në këtë rast shfrytëzohet energjia e çliruar nga djegia e sheqerit gjatë frymëmarrjes qelizore.

**2.22 1.** Floema dhe ksilema. Kambiumi është ind që ndahet.

**2.** Një pjesë e bimës, në të cilën përthithet një lëndë ose përpunohet. Gjethet janë

burimi i glukozës, ndërsa rrënjët burim i ujit dhe joneve minerale.

**3.** Gjatë fundit të verës dhe fillimit të vjeshtës sheqeri fillon të lëvizë drejt rrënjëve ku depozitohet, në pranverë lëviz nga rrënjët drejt gjetheve dhe pjesëve që rriten si sythet dhe lulet.

**4.** Për të furnizuar energji nga frymëmarrja: pikat rritëse kërkojnë energji për ndarjen qelizore, ndërsa rrënjët kërkojnë energji për transportin aktiv të joneve minerale.

**5.** Ngjyruetit hidhen në një vazo dhe nëse ngjiten lart me anë të ksilemës ndryshojnë ngjyrën e petaleve të lules.

**2.24 1** (faqe 80)

**d.** 2.4; 4.3; 35.9; 39.0

**2.** Në sipërfaqen e poshtme ka më shumë gojëza: uji humbet përmes gojëzave në formën e avullit e për rrjedhje gjethja humbet në peshë.

**3.** Sepse kështu nuk do të kishte ndryshime gjenetike mes gjetheve, të cilat do të ishin përgjegjëse për përshtatshmëri të veçanta në ruajtjen e ujit.

**4.** Duhet të përsëritet eksperimenti dhe të përdoren vlerat mesatare të rezultateve. Herë pas here përdoret pak vazelinë. Përdoren gjethe të së njëjtës madhësi/të së njëjtës sipërfaqe.

**1.** (faqe 81)

**a.** Prerja transversale bëhet kur gjethja pritët në mes.

**b i.** Fotosinteza

**ii.** Dioksidi i karbonit

**iii.** Difuzioni: lëvizja e molekulave sipas gradientit të përqendrimit

**c.** Qimet parandalojnë lëvizjen e avullit të ujit/gojëzat janë në gropëza për të penguar largimin e avullit të ujit/kutikula e trashë dyllore pengon humbjen e ujit përmes sipërfaqes së jashtme.

**d.** Për fotosintezën/mbështetje nga turgori/transporti i joneve në ksilemë.

**e.** Dunat ranore nuk kanë shumë ujë e për rrjedhje bimët që rriten aty e kanë të vështirë zëvendësimin e ujit të humbur.

**2.** rryma e transpirimit; dioksid karboni; gojëza; avull uji; kutikulë e trashë dyllore/ rrotullimi i gjethes/qimet në sipërfaqe të gjethes.

**2.25 1.** Sepse raporti sipërfaqe/vëllim është shumë i vogël për kapjen e gazeve/ humbjen e mbetjeve. Kur një organizëm bëhet më i madh, ai ka nevojë për një sistem transporti që lëviz lëndët për dhe nga sipërfaqja që shfrytëzohet për shkëmbim, si për shembull mushkëritë





dhe veshkat.

- 2 a. Rruazat e kuqe të gjakut dhe plazma.
  - b. Glukoza/ngrohje me reagentin e Benediktit/rezultati pozitiv jep precipitat me ngjyrë portokalli në të verdhë.
  - c. Rruaza të bardha të gjakut
3. Rruaza të kuqe të gjakut transportojnë oksigjenin. Ato janë përshtatur duke humbur bërthamën (janë shumë të luhatshme dhe kanë sipërfaqe të madhe për kapjen/humbjen e oksigjenit); prania e hemoglobinës (për lidhjen e oksigjenit). Rruazat e bardha të gjakut kanë për funksion mbrojtjen e organizmit. Janë përshtatur për të pasur bërthamë me formë të çrregullt (ndihmon në kalimin përmes kapilarëve) dhe citoplazmë të pasur me enzima tretëse (për të zbrëthyer mikrobet e gëlltitura)
  - 4 a. Bledi: ka shumë rruaza të kuqe si një përshtatshmëri për nivelin e ulët të oksigjenit në lartësi të mëdha.
  - b. Bledi: ka përqendrim të ulët të rruazave të bardha të gjakut, të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen kundër sëmundjeve.
  - c. Teuta: ka numër të ulët të pllakëzave të gjakut (fragmente qelizore), të cilat duhen për mpiksjen e mirë të gjakut.
  - d. Genta: ka numër të vogël të rruazave të kuqe të gjakut. Për prodhimin e hemoglobinës së rruazave të kuqe duhet hekur.
  - c. Kjo gjë shmang çdo ndryshim në numrin e rruazave të kuqe të gjakut në funksion të gjinisë ose moshës. Këta faktorë përbëjnë ndryshore të fiksuara.
5. qeliza; inde; epiderma; organ; i specializuar; rruazë e kuqe gjaku; ndarje pune.

- 2.26 1. Arteriet kanë mure elastike dhe shtresa muskujsh (për t'u përshtatur me presionin e gjakut dhe për ta shtyrë këtë të fundit para); venat kanë mure të hollë (nuk ka puls për ta përballuar), dhe valvola (shmangin kthimin e gjakut mbrapa).
2. Ai kalon dy herë. Vena renale - vena cava - atriumi i djathtë - ventrikuli i djathtë - arteria pulmonare - (mushkëri) - vena pulmonare - atriumi i majtë - ventrikuli i majtë - aorta - arteria renale.

- 2.27 1 a. A: gjaku, B: ind i lëngët, C: limfa.
- b. Oksigjeni/glukoza/aminoacide. Dioksid karboni/ureja.
- c. Kthehet me anë të enëve limfatike për të mbërritur në gjak me anë të duktit të kraharorit që ndodhet afër atriumit të djathtë (kur presioni i gjakut është shumë

i ulët).

c. Nëse potenciali i ujit të gjakut është i lartë, p.sh. përqendrimi i proteinave ose glukozës në plazmë është shumë i ulët. Indet do të veniten. Një gjë e tillë mund të shmanget vetëm nëse dieta do të përmbajë sasinë e mjaftueshme të proteinave.

#### 2.28 1 a. Atriumi i majtë

b. Gjaku detyrohet të kalojë përmes valvulës semilunare për të vazhduar më tej në aortë.

c. Sepse atriumi mjafton të shtyjë gjakun drejt ventrikulit (jo shumë larg) ndërkohë që barkushet e shtyjnë gjakun drejt indeve të largëta.

#### 2 a. Përmes mbylljes së valvulës gjatë ciklit kardiak.

b. Çdo rrahje bën një zhurmë "lup-dup", pra ka një zhurmë "lup" në çdo cikël. Çdo cikël zgjat 60/72 sekonda, d.m.th. intervali mes dy tingujve "lup" është 0.8 sekonda.

#### 2.29 1 a. Arteriet koronare

b. Është e vështirë që gjaku të kalojë përmes vendit të bllokimit. Qelizat pas vendit të bllokimit nuk furnizohen me oksigjen. Ato vdesin.

#### 2 a. Në moshën 23 dhe 46 vjeç.

b. Kolesterolit i gjakut është më i lartë te meshkujt. Niveli i vdekjeve rritet me rritjen e nivelit të kolesterolit.

c. Më pak se 4 njësi arbitrare.

d. Ka edhe faktorë të tjerë deri sa rreziku kurrë nuk bie në zero.

e. Meshkujt duhanpirës, të cilët konsumojnë shumë ushqime me yndyra dhe merren pak me sport.

#### Qarkullimi (faqe 94–95)

- 1 a. Glukoza: gypi ushqimor në muskuj/mëlçi; aminoacidet: nga gypi ushqimor në muskuj/mëlçi; oksigjeni: nga mushkëritë në inde; dioksidi i karbonit nga indet frymëmarrëse për në mushkëri.
- b. 8000 për mm<sup>3</sup>: rriten gjatë infeksioneve
- c.  $5\,000\,000/8000 = 625:1$
- d. Tymrat e makinave/djegjet e lëndëve djegëse për qëllime shtëpiake/tymi i cigares.
- e. Bie, ndërsa monoksidi i karbonit lidhet me rruazat e kuqe të gjakut, këto të fundit nuk mund të lidhin dhe transportojnë oksigjenin.
- f. 120 ditë: koha e zëvendësimit të rruazave të kuqe të gjakut.
- g. Rruazat e kuqe të gjakut të plakura largohen dhe hekuri i hemoglobinës së tyre ruhet në mëlçi.

- 2 a.** Aorta  
**b.** Vena pulmonare  
**c.** Arteria pulmonare  
**d.** Vena hepatike  
**e.** Vena cava (nga vena iliake)  
**f.** Vena portë-hepatike  
**g.** Arteria pulmonare
- 3 a.** Bie (rreth 17 kPa në rreth 2 kPa)  
**b.** Gjaku detyrohet të lëvizë drejt indeve frymëmarrëse  
**c.** Valvulat  
**d.** Ato rrethohen nga sfinketërt (muskuj unazorë), të cilët tkurren ose relaksohen për të rregulluar rrymën e gjakut drejt indeve të ndryshme.  
**e.** Trashësia e një qelize, pra largësi e vogël për difuzionin/kanë pore, të cilat lejojnë transferimin e shpejtë të lëndëve të tretura në inde.
- 4 a.** Vena portë-hepatike – vena hepatike – vena kava – atriumi i djathtë – ventrikuli i djathtë – arteria pulmonare – vena pulmonare – atriumi i majtë – ventrikuli i majtë – aorta – muskuli i këmbës.  
**b.** Vena pulmonare – atriumi i majtë – ventrikuli i majtë – aorta – truri - vena cava – atriumi i djathtë – ventrikuli i djathtë – arteria pulmonare.

5

Ritmi	55	70	80	90	120	140	150	170
Nxjerrja për çdo rrahje	0.07	0.068	0.064	0.068	0.05	0.042	0.038	0.027

- b.** Punoni me kujdes grafikun.  
**c i.** Rritet deri sa arrin pikun dhe pastaj ulet.  
**ii.** Nxjerrja e gjakut gjatë çdo rrahjeje bie ndërsa ritmi rritet.  
**d i.** Nuk ka ndonjë fitim në raport me nxjerrjen e përgjithshme të zemrës.  
**ii.** Nxjerrja e gjakut për rrahje mund të jetë e lartë (muskuli i zemrës është më elastik te atletët e trajnuar).  
**e.** Ka pak gjasa që muskuli i zemrës të lodhet/ritëm i ulët do të thotë se ka akoma shumë për të bërë për të arritur te piku i ritmit.  
**f.** Për të furnizuar më shumë oksigjen, i cili transportohet me anë të gjakut drejt indeve frymëmarrëse.
- 6 a i.** Po  
**i.** Jo  
**b.** Sepse eliminon dy ndryshore të tjera (gjinia dhe pirja e duhanit, të cilat mund të ndikojnë në zhvillimin e sëmundjeve kardiovaskulare).
- 7 a.** Për tabelën e parë ndërtoni një grafik vijëzor, ndërsa grafiku për tabelën e dytë duhet me shtylla (kujdes që shtyllat mos të takohen).

**b i.** Më shumë kolesterol i lartë në gjak.

**ii.** 9.9 herë më shumë (3.2 x 3.1).

- 8 a.** Pak ushtrime/pirja e duhanit.  
**b.** Yndyra të larta/kolesterol/kripë.  
**c.** Meshkujt.

- 2.30 1.** Ato mund të jenë të dëmshme sepse shkaktojnë sëmundje (d.m.th. si patogjene), prishin ushqimet dhe dëmtojnë materialet e ndërtimit, siç janë drurët e shtëpisë. Ato mund të jenë gjithashtu të dobishme sepse kryejnë fermentim (përgatitja e bukës dhe birrës), dekompozimin e mbetjeve bimore e shtazore (cikli i karbonit dhe azotit), si dhe përdoren për inxhinierinë gjenetike.
- 2.** Sëmundje degjenerative, si p.sh. trashja e arterieve; sëmundje të pamjaftueshmërisë, si p.sh. rakitizmi; sëmundjet trashëguese, si p.sh. anemia falciforme.
- 3.** Me ujin e infektuar (p.sh. kolera); me anë të kontaktit të drejtpërdrejtë (sëmundjet ngjitëse), p.sh. “këmba e atletit”; me anë të vektorëve shtazorë, p.sh. malaria; me pikëzat e ajrit, p.sh. gripi (virus); me ushqimin e ndotur, p.sh. helmimi ushqimor nga Salmonela; me anë të lëngjeve të trupit, p.sh. AIDS.
- 4.** Shenjat janë ndryshime që tregojnë se një individ është i sëmurë. Ato mund të dallohen nga një mjek, p.sh. rritja e temperaturës; simptomat përjetohen nga i sëmuri, p.sh. “të ndihesh i sëmurë”. Simptomat tipike të sëmundjes shkaktohen nga shumimi i patogjenëve ose prodhimi i helmeve të tyre. Organizmi synon eliminimin e patogjenëve.
- 5.** Në Shqipëri, si dhe në shumë vende të tjera europiane, ekzistojnë programe vaksinimi, të cilat minimizojnë efektet e fruthit. Kujdesi i mirë shëndetësor ndihmon cilindo që bie në kontakt me sëmundjen. Vendet e pazhvilluara ekonomikisht shpesh nuk arrijnë t’i ndërmarrin këto masa.
- 6.** Ndryshimet në sjelljet seksuale ka gjasa të kenë rritur rrezikun e prekjes nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme, si p.sh sifilizi.

- 2.33 1.** Përmirësimi i higjienës personale (ka më pak shanse për t’u infektuar); konsumimi i një diete të balancuar (më pak shanse për sëmundje të pamjaftueshmërisë, si p.sh rakitizmi); mospirja e duhanit (pakëson rrezikun e kancerit të mushkërive/sëmundjeve të sistemit kardiovaskular).
- 2.** Sigurimi i ujit të pijshëm të pastër, largimi i mbeturinave dhe sigurimi i kujdesit



shëndetësor për të sëmurët.

3. Viral (AIDS); bakterial (gonorreja)

4. AIDS (virusi HIV): individi duhet të kontrollojë sjelljet seksuale të pambrojtura; komuniteti duhet të sigurojë kujdesin e duhur shëndetësor; shkencëtarët duhet të punojnë për të prodhuar barna mjekësore të reja.

2.34 1. Lëkura është një barrierë: ajo prodhon sekrecione në trajtë dyllore dhe me lëndë baktericide (vrasëse të baktereve), të cilat i pengojnë patogjenët që rriten në ujë të futen në lëkurë dhe të përfundojnë në gjak. Patogjenët ushqehen me lëngjet e organizmit ose indet e ndryshme. Aty ata shumohen dhe shkaktojnë sëmundje përmes shkatërrimit të qelizave ose prodhimit të helmeve.

2 a. Të parandalojë humbjen e gjakut/hyrjen e patogjenëve.

b. Nëse koaguli është i brendshëm mund të bllokojë enët të rëndësishme të gjakut duke ndërprerë furnizimin e indeve dhe organeve me oksigjen dhe lëndë ushqyese.

i. Kjo do të thotë që një sinjal fillestar i dobët mund të shkaktojë një përgjigje të shpejtë dhe të fuqishme.

ii.  $10\,000\,000\,000\text{ dmth } 10^{10}$

3. Gjatë fagocitozës, patogjenët ose pjesëzat e dëmshme gëlltiten nga rruazat e bardha të gjakut (fagocitet). Qelizat formojnë një vakuolë rreth patogjenit (një figurë do t'ju ndihmonte të bënit përshkrimin). Fagocitet janë shumë të luhatshme (fleksibël) dhe përmbajnë enzima tretëse që zbërthejnë patogjenët e gëlltatur. Patogjenët mund t'i shpëtojnë fagocitozës, duke u fshehur brenda qelizave ose duke qëndruar në zona ku ka pak fagocite (siç është gypti ushqimor).

2.35. 1. Përmes njohjes së molekulave në sipërfaqe të patogjenëve. Këto molekula nuk gjenden në qelizat e bujtësit.

2. Limfocitet kanë bërthamë sferike, ndërsa fagocitet kanë bërthamë me formë të çrregullt.

3. Patogjenët njihen nga limfocitet B. Këto të fundit prodhojnë antitropa që shkatërrojnë patogjenët. Disa prej limfociteve, të cilat prodhojnë antitrupat, ruhen në plazmë dhe shërbejnë si qeliza të kujtesës. Ato janë të gatshme të sulmojnë të njëjtat patogjene në rast të një infeksioni të përsëritur.

2.37 1 B

2 c. Shndërrimi i energjisë nga një formë në tjetrën: Shndërrimi i energjisë së

diellit në energjinë kimike të ushqimit ndodh gjatë fotosintezës. Ky është hapi kyç i fillimit të zinxhirëve ushqimorë. E gjithë energjia më në fund çlirohet si nxehtësi.

3 a. Në boshtin  $x$  vendoset koha, ndërsa përqendrimi i acidit laktik në boshtin  $y$ . Piku i përqendrimit arrihet pas 25 minutash.

b. 18 njësi arbitrare.

c. 15 minuta

d. Sepse ai vazhdon të prodhohet në muskuj dhe pastaj "pastrohet" nga gjaku.

e. Muskuj

f 55. Minuta (pastaj kthehet në vlerën 18 njësi arbitrare).

2.38 1 a. Vetëm kështu ata mund të përlllogaritin vlerën mesatare. Farat 0.40 mm për sek.: larvat: 0.52 mm për sek.

Larvat janë më aktive se farat, prandaj kërkojnë më shumë energji për të lëvizur.

2. Si kontroll, për të parë nëse faktorë të "panjohur" mund të shkaktojnë lëvizjen e lëngut të ngjyrosur.

3 a. Temperatura në boshtin  $x$ , ndërsa konsumi i oksigjenit në bishtin  $y$ : piku arrihet në temperaturën  $35^{\circ}\text{C}$ . Kjo përkon me temperaturën optimale në të cilën veprojnë enzimat e përfshira në frymëmarrje.

b. Temperatura është ndryshorja e pavarur, ndërsa konsumi i oksigjenit është ndryshorja e varur.

c. Peshë e organizmave/sipërfaqja e filtrit të letrës/lloji i lëngut të ngjyrosur.

4. Për të larguar dioksidin e karbonit nga ajri para se ai të bjerë në kontakt me organizmat e gjalla.

5 a. Dioksidi i karbonit qëndron në ajër.

6. Organizmat në C çlirojnë  $\text{CO}_2$ . Ky është një gaz acid, ndaj indikator i ndryshon ngjyrën.

7 f. Nuk ka organizma në C. Kjo tregon se indikator nuk mund ta ndryshojë ngjyrën ndaj faktorëve të panjohur.

8. Muret e enës së qelqit të bëhen të mjegullt: Organizmat çlirojnë ujë gjatë frymëmarrjes.

2.39 1. E hollë, sipërfaqe e madhe, afër me enët e gjakut, ajrosje e mirë.

2 c. Përgjatë rrugëve të ajrit: goja, trakeja, bronket, bronkiolat. Në vijim kalimi i oksigjenit nga alveolat në rruazat e kuqe të kapilarëve, pastaj nga kapilarët në lëngun indor e prej andej në qelizat e organizmit (p.sh. qelizat e mëlçisë).

3. Oksigjeni transportohet në sasi të madhe

- falë përqendrimin të lartë të hemoglobinës në rruazat e kuqe. Rruazat e kuqe kanë për funksion transportin e oksigjenit. Ato janë përshtatur për të pasur një sasi të madhe hemoglobine (për lidhjen e oksigjenit), meqenëse bërthama mungon. Rruazat e kuqe janë shumë të luhatshme dhe kanë një sipërfaqe të madhe për kapjen ose çlirimin e oksigjenit.
- 4.** Frymëmarrja qelizore është çlirimi i energjisë nga molekulat ushqimore. Shkëmbimi i gazeve nënkupton marrjen e oksigjenit dhe largimin e dioksidit të karbonit, në funksion të zhvillimit të frymëmarrjes qelizore.
- Shkëmbimi i gazeve (faqe 118-119)
- 1 a.** Vizatimi i grafikut në mënyrën e duhur: koha vendoset në boshin x.
- b.** Agimi: ai bën më pak frymëkëmbime gjatë vrapimit.
- c.** 8:1 (4:0.5)
- d.** 30 frymëkëmbime në minutë (secila zgjat dy sekonda).
- e.** Rritet si ritmi, ashtu edhe thellësia e frymëkëmbimit.
- f.** Ritmi i zemrës rritet deri në maksimum me rritjen nivelit të ushtrimeve.
- g.** Frymëmarrja e muskulit përfiton me më shumë oksigjen (dhe glukozë).
- 2 a.** Diafragma.
- b.** Mund të shfryhet.
- c.** Frymënxjerrje.
- d.** Nuk tregohen muskujt ndërbrinjorë.
- e.** 1. brinjët; 2. sternumi; 3. muskujt ndërbrinjorë (të jashtëm); 4. vertebra/shtylla kurrizore.
- f.** Frymëmarrja realizohet nga tkurrja e muskujve ndërbrinjorë dhe diafragmës. Ky proces është aktiv. Frymënxjerrja ndodh kur muskujt ndërbrinjorë dhe diafragma relaksohen. Ky proces është pasiv.
- 3 a i.** Vrapuesit e maratonës e shfrytëzojnë energjinë në rezervë (glukozë, glikogjen dhe yndyra), 4 herë më shumë se individët që vetëm ecin.
- ii.** Glukoza e gjakut dhe glikogjeni i muskujve.
- iii.** Yndyrat, sheqernat.
- b i.**  $C_6H_{12}O_6 \rightarrow 2C_3H_6O_3 = 2 \text{ ATP}$
- ii.** Një sprinter shfrytëzon frymëmarrjen aerobe, meqenëse prodhimi i laktatit (helm muskolor) është më i ulët gjatë garave të shkurtra.
- iii.** Glikogjeni i mëlçisë hidrolizohet deri në molekula glukozë (proces që nxitet nga hormonet adrenalinë dhe glukagon), të cilat prej andej kalojnë në gjak. Përqendrimi i glukozës qëndron i pandryshuar deri sa glukoza e tepërt konsumohet nga muskujt për frymëmarrje qelizore.
- 4 a.** Ju mund të përmendni katër nga këto veçori: të ushqyerit, riprodhimi, ekskretimi, rritja, zhvillimi, ndjeshmëria dhe lëvizja.
- b.** Frymëmarrja është çlirimi i energjisë nga oksidimi i ushqimit (zakonisht glukozës). Shkëmbimi i gazeve është procesi i largimit të dioksidit të karbonit nga organizmi dhe zëvendësimi i tij me oksigjenin. Frymëkëmbimi është i domosdoshëm për zhvillimin e frymëmarrjes aerobe.
- 5 a i.** Duhanpirja
- ii.** Duhanpirja shkakton një pakësim prej 3.4%, ndërsa drejtimi i automjetit (eksponimi në tymin e makinave) shkakton pakësim deri në 2.4%.
- iii.** Ndryshimi mes taksistëve duhanpirës të ditës dhe natës është 1.3%. Kjo shpjegohet me trafikun e rënduar gjatë ditës që çliron më shumë monoksid karboni.
- b i.** Nikotina që shkakton varësi dhe rrit ritmin e zemrës: katrani që rrit rrezikun për shfaqjen e kancerit të mushkërive.
- ii.** Fetusi mund të lindë nën peshë për shkak të mungesës së oksigjenit. Bebja mund të bëhet e varur ndaj nikotinës qysh në lindje.
- 2.40 1.** Ndërsa muskuli tkurret, rritet vëllimi i kafazit të kraharorit. Mushkëritë e ndjekin këtë rritje e për rrjedhojë ajri hyn brenda.
- 2.** Ritmi i frymëkëmbimit. Vëllimin e ajrit që hyn në mushkëri gjatë qëndrimit në pushim dhe gjatë stërvitjes. Vëllimin e ajrit të tepërt që hyn në mushkëri, në raport me atë që hyn gjatë frymëkëmbimit normal. Vëllimin maksimal të mushkërive.
- 3.** Frymëmarrja aerobe shfrytëzon oksigjenin e ajrit të thithur dhe çliron dioksidin e karbonit në ajrin që nxirret.
- 2.41 1.** Pjesëzat nxitin veprimin e fagociteve, si dhe qelizat që sekretojnë mukus (sasia e mukusit rritet). Tymi than veshjen e brendshme të mushkërive. Lëndët kimike të tymit mund të nxitin ndarjen e tepruar të qelizave, duke shkaktuar vatra tumorale në mushkëri dhe rrugët e ajrit.
- 2.** Fizike: organizmi nuk funksionon në mungesë të lëndëve kimike. Psikologjike: përdoruesit besojnë se lëndët kimike reduktojnë stresin ose rritin kënaqësinë. Përmes ofrimit të pjesëve me nikotinë që vendosen në lëkurë (për të kapërcyer varësinë fizike) ose përmes konsultimit



- (kapërcimi i varësisë psikologjike).
3. Rrit presionin arterial/dëmtime të zemrës/ kancer të fshikëzës së urinës.
  4. Nga humbja e aftësisë lëvizëse të cilieve (qerpikëve).
  - 5 a. 1000
  - b.  $6 \text{ cm}^3$
  - c.  $6\,000 \text{ cm}^3$
  - d.  $600 \text{ cm}^3$

- 2.42 1.** Epidemiologjia është dega e shkencës mjekësore që merret me rastet, shpërndarjen dhe kontrollin e sëmundjeve në popullatë.
2. Puna në mjedise me tym duhani ose me pluhura. Puna në mjedise me pezulli pjesëzash, si p.sh. në miniera.
  3. Afërsisht 24 herë
  4. Njerëzit që jetojnë afër linjave të tensionit të lartë dhe njerëz që jetojnë larg tyre:  
të gjithë me moshë njëjtë;  
të gjithë të një gjinie;  
të gjithë me të njëjtin profesion;  
me dietë të përafërt sa të mundet.
  5. Nuk do të ishte etike të detyronim dikë që të pinte duhan për të pritur shfaqjen e kancerit të mushkërive.

- 2.43 1.** Ekskretimi: largimi i mbetjeve metabolike dhe lëndëve në tepricë. Osmorregullimi: kontrolli i balancës së ujit (hidrike) në organizëm.
2. Dioksidi i karbonit: nga frymëmarrja qelizore; largohet gjatë frymënxjerrjes. Ureja nga deaminimi i aminoacideve në qelizat e mëlçisë; largohet me anë të veshkës.
  3. veshka, arteria renale, nefronet, e Baumanit, glukoza, ripërthithje përzgjedhëse, ureterët, fshikëza e urinës, uretra.

- 2.44 1 a.** Për të mbajtur citoplazmën e qelizës të hidratuar.
- b Në ushqim ose pije.
  - c Me urinën, djersën dhe frymënxjerrjen.
  2. Në “feedback”-un negativ ndryshimi i një faktori shkakton një përgjigje që i kundërvihet këtij ndryshimi.
  3. Transplanti është më i përshtatshëm për pacientin. Ai siguron një funksion të natyrshëm për organizmin. Sigurimi i një veshke nuk është i lehtë dhe mund të ndodhë flakja e saj.

- 2.45 1.** indor; receptorët; optimum; truri; ndijor; “feedback” negativ.

## 2

Organi homeostatik	Faktori që kontrollohet
Mëlçia	Përqendrimi i glukozës së gjakut
Mushkëritë	Përqendrimi i oksigjenit dhe dioksidit të karbonit
Veshka	Përmbajtja e ujit në gjak
Lëkura	Humbja ose fitimi i nxehtësisë
Zorrët	

3. Glukoza e gjakut zbulohet nga pankreasi. Nëse përqendrimi i saj është i lartë sekretohet insulina, e cila ul sasinë e sheqerit në gjak, duke nxitur formimin e glikogjenit në mëlçi. Përqendrimi i glukozës në gjak rikthehet në vlerën optimale. Temperatura në kabinën e një aeroplani zbulohet nga një sensor termik. Informacioni dërgohet në një kompjuter. Ky i fundit dërgon një mesazh elektrik te ngrohësi. Ky i fundit fiket ose ndizet për të kthyer temperaturën në gjendjen optimale.

### Ekskretimi dhe homeostaza (faqe 133-135)

- 1 a. Gjendje gjatë së cilës temperatura bie poshtë nivelit normal.
- b. Të vjetrit kanë qarkullim më pak efikas, ndaj dhe sistemet e kontrollit të temperaturës nuk punojnë shumë mirë.
- c. Fëmijët kanë një raport sipërfaqe/vëllim të madh. Kjo është arsyeja se pse nxehtësia humbet më shpejt sesa fitohet.
- 2 a. Çdo ndryshim në temperaturën e trupit zbulohet nga një sensor. Në vijim një përgjigje korigjuuese (dridhjet/djersitja; ngushtimi i enëve të gjakut të lëkurës/ zgjerimi i enëve të gjakut të lëkurës) e kthen temperaturën e trupit në atë normale.
- b. Dridhjet janë tkurrje të shpejta të muskujve. Nga ky veprim prodhohet nxehtësi gjatë frymëmarrjes qelizore (një pjesë e nxehtësisë prodhohet nga fërkimi).
- c. Mëlçia është qendra kryesore e metabolizmit e për rrjedhojë aty prodhohet edhe pjesa më e madhe e nxehtësisë (kryesisht nga frymëmarrja qelizore).
- d. “Feedback”-un negativ, çdo ndryshim nga vlera optimale/norma shkakton një përgjigje që korigjon ndryshimin.
- 3 a. Tregohet arteria e lidhur me aortën, vena me venën zgavrë (cava) dhe ureterët me fshikëzën e urinës.

**b.** Flakja ndodh kur organizmi zbulon se veshka nuk i përket marrësit (recipientit) dhe sistemi imunitar prodhon më shumë qeliza për të sulmuar transplantin.

**c.** Gypthat e nefronit të veshkës përzgjedhin se cilat lëndë duhet të humbasin dhe cilat duhet të ripërthihen e të kthehen nga urina në gjak. Kthimi i lëndëve të dobishme nga urina në gjak bëhet me anë të transportit aktiv.

**4 a.** Ureja largohet nga gjaku me difuzion në përputhje me gradientin e përqendrimit (lëngu i dializës ka përqendrim shumë të vogël të uresë).

**b i.** Veshka e transplantuar kryen të gjitha funksionet e një veshke normale. Ndërkaq ajo nuk paraqet rreziqe për infeksione si në rastin e dializës që realizohet përmes një lidhjeje të jashtme.

**ii.** Veshka mund të flaket. Kjo ndodh kur organizmi zbulon se organi nuk i përket marrësit e për rrjedhojë sistemi imunitar prodhon më shumë qeliza që sulmojnë transplantin.

**5 a i.** Koha vendoset në boshtin  $x$ , ndërsa boshti  $y$  shërben për tre lakoret.

**ii.** A ftohet më shpejt (deri në  $45^{\circ}\text{C}$ ) se B (deri në  $60^{\circ}\text{C}$ ); B më ngadalë se C dhe C pak më shpejt sesa (deri në  $40^{\circ}\text{C}$ ) se A.

**iii.** B rrethohet me pambuk të thatë, prandaj nxehtësia humbet më ngadalë. A është e “zhveshur” dhe C që është e mbuluar me pambuk të lagur e përdor një pjesë të nxehtësisë për avullimin e ujit të pambukut.

**b i.** Balonat kanë të njëjtën sipërfaqe/përmbajnë të njëjtën sasi uji/kanë të njëjtën temperaturë uji në fillim të eksperimentit/temperatura e mjedisit është e njëjtë për të tri balonat.

